

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI: " RIKONSTRUKSION I PEDIATRISE, SARANDE "

LOTI 1: FINANCIM NGA BANKA RAIFFEISEN – PUNIME

RIKONSTRUKSIONI SIPAS GRAFIKUT SIPAS GRAFIKUT

LOTI 2: FINANCIM NGA D.SH.S.S. – PUNIME RIKONSTRUKSIONI SIPAS

GRAFIKUT

D.SH.S.S.

1. Objekti i Rikonstruksionit

Objekti i i punimeve per rikonstruksionin e pavionit te Pediatrise ne spitalin e Sarades eshte kryesisht riorganizimi funksional i ambienteve si dhe rinovimi i ambienteve me materiale dhe instalime sipas kerkesave bashkekohore dhe ligjore te Shtetit Shqiptar. Nderhyrjet ne objekt do te kryhen me dy faza pasi financimi do te jete nga dy institucione te ndryshme.

Ne lotin e pare, punime te cilat financohen nga Banka Raiffeisen, do te kryhen keto punime:

- Punime per prishje muresh dhe heqje duraluminesh;
- Punime murature dhe betoni;
- Punime suvatimi e veshje – per banjat qe jane projektuar;
- Punime shtresash per banjat qe jane projektuar
- Punime hidrosanitare per furnizimin me uje dhe shkarkimet e ujrave te zeza per banjat qe do te projektohen;
- Punime elektrike per rinovimin dhe vendosjen e sistemeve te reja elektike;

Per sa i perket ketyre punimeve eshte hartuar preventiv me volumet dhe vlerat perkatese.

keto punime jane kryer ne objekt pasi u krijua mundesia e financimit nga Banka Raiffeisen.

Ne lotin e dyte, punime qe do te financohen nga Drejtoria e Shendetit Spitalor Sarande, do te kryhen keto punime:

- Punime te ndryshme – vendosje adezivi, dhe vendosje portash te brendshme;
- Punime suvatimi e veshje – per dhomat e pacienteve dhe ambientet e tjera funksionale;
- Punime shtresash – per dhomat e pacienteve dhe ambientet e tjera funksionale;
- Punime hidrosanitare per furnizimin me uje dhe shkarkimet e ujrave te zeza te lavamaneve qe do te vendosen ne dhomat funksionale;
- Punime elektrike per vendosjen e paisjeve te instalimeve tek kryera ne lotin 1;

2. Gjëndja Ekzistuese e Objektivit.

Pavioni i Pediatrise eshte nga te vetmit ne Spitalin e Sarandes qe nuk pati rinovime gjate 5 vjecarit te fundit ku u kryen disa investime ne kete spital. Ne kete pavion pllakat e sheshit jane te vjetra, ndoshta nuk jane nderruar asnjehere ne menyre totale. Muret kane defekte dhe duhen riparuar. Disa prej instalimeve elektrike nuk funksionojne dhe jane vendosur pa rregull. Banjat jane te vjetra dhe jo me funksionalitet te mire. Dhomat e mjekeve kerkojn rinovime ne mure dhe ne instalime. Portat e dhomave jane prej duralumini te cilesise mesatare dhe nuk krijojne privatesine e duhur per pacientet. Organizimi i pavionit eshte jasht kushteve bashkekohore dhe jep rezultate te dobeta ne mirefunksionimi shendetesor. Keto jane disa prej pikave kryesore te konstatuara ne objekt.

2.1. Programi i rikonstruksionit

Synimi i detyrës, si dhe i punës së grupit te projektimit, ka qënë realizimi i projektit per rikonstruksionin e Pavionit te Pediatris te Spitalit Sarande, i cili ka nevojte per nderhyrje te menjehershme per realizimin e punimeve te cituara me larte. Ne kete pavion do te kryhen ndryshime ne funksionin e tij duke krijuar ambiente te reja.

Keto ambiente permbajne:

- Banja per publikun;

- Hyrje (fuaje) per kalimin e pacienteve;
- Dhome manipulimi;
- Dhome e mjekut me banje;
- Banje e re per pacientet me dush per funksionin shendetesor;
- Banja per personelin;
- Reception;
- Depo magazine;

Vec krijimit te ambienteve te reja ne objekt do te kryhen punime per instalimin e ujit te pishem dhe shkarkimeve te ujrave te zeza, suvatime, tavane me kartonxhes, pllaka te reja ne shesh, dyer druri te brendhsme, dritare duralumini, instalime elektrike dhe sistem kondicionimi, lysterje, etj..

Per punimet jane zbatuar te tera kushtet teknike dhe teknologjite e reja per instalimet dhe pjesen e energjitikessi dhe te komunikacionit.

COMASS-ART shpk
Arch. EDMOND RUMANI
Lic. A.1279/1

